# ABSTRAKT

Një nga shtyllat kryesore të Unionit Evropian patjetër që është procedura legjislative, përkatësisht funksionimi, arritja e qëllimeve, struktura organizative si dhe rëndësia e këtij procesi. Si procedurë aq sa është e komplikuar, në dukje të pare, poaq detl të jetë e lehtë të zbatohet në rrafshin praktik. Procedura e bashkëvendosjes u prezantua për herë të parë në vitin 1992 dhe përdorimi i saj u zgjerua në vitin 1999. Me miratimin e Traktatit të Lisbonës, bashkëvendimi u riemërua në procedurë të zakonshme legjislative dhe u bë procedura kryesore e vendimmarrjes e përdorur për miratimin e legjislacionit të UE-së. Ai zbatohet në rreth 85 fusha të politikave të Unionit Evropian. Komisioni Evropian është i vetmi institucion i UE-së i autorizuar për të iniciuar akte ligjore të UE-së. Propozimet për aktet ligjore të UE-së i paraqet me iniciativën e vet, me kërkesë të institucioneve të tjera të UE-së ose me nismë qytetare. Para se Traktati i Lisbonës të hynte në fuqi në fund të vitit 2009, procedura legjislative më parë quhej apo është emërtuar procedura e bashkëvendosjes. Karakteristika thelbësore e këtaj procedure është se si Këshilli i Ministrave ashtu edhe Parlamenti Evropian kanë një votë vendimtare në procesin legjislativ dhe të dy institucionet mund të ndryshojnë një propozim.

Në këtë studim timin do të fokusohem më së shumti në shpjegimin se si fillon kjo procedurë që nga fillimi dhe deri tek aprovimi që ai akt ligjor të hyj në fuqi si dhe duke treguar raste të ndryshme në momentin kur ka pasur konflikt interesash në mes të shteteve anëtare të UE-së.

# ABSTRACT

One of the main pillars of the European Union is definitely the legislative procedure, respectiely its functioning, the achievement of goals, the organizational structure and the importance of this process. As a procedure, as complicated as may be seen, it appears as easy to implement it in practice. The co-decision procedure was first introduced in 1992 and its use was extended in 1999. With the adoption of the Treaty of Lisbon, co-decision was renamed the ordinary legislative procedure and became the main decision-making procedure used to adopt legislation of the EU. It is applied in about 85 policy areas of the European Union. The European Commission is the only EU institution authorized to initiate EU legal acts. It submits proposals for EU legal acts on its own initiative, at the request of other EU institutions or by citizens' initiative. Before the Treaty of Lisbon entered into force at the end of 2009, the legislative procedure was previously called or is called the co-decision procedure. The essential feature of this procedure is that both the Council of Ministers and the European Parliament have a decisive vote in the legislative process and both institutions can change a proposal.

In this study, I will focus mostly on explaining how this procedure starts from the beginning and until the approval for that legal act to enter into force, as well as showing different cases when there was a conflict of interests between the states member of the EU.